



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2022/prot.  
3

Tiranë, më 23.07.2024

**VENDIM**

**Nr. 36 , datë 23.07.2024**

**PËR**

**“MIRATIMIN E BURSËS FINANCIARE, SIPAS KRITERIT EKONOMIK, PËR STUDENTEN LUELA TERZIU, E CILA STUDION NË NJË PROGRAM STUDIUMI TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”**

Në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit pasi mori në shqyrtim Relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 1935/1 prot., datë 10.07.2024 “Mbi miratimin e kërkesës për bursë për vitin akademik 2023-2024, për studenten e Fakultetit të Mjekësisë, Luela Shyqyri Terziu”,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë bursën financiare sipas kriterit ekonomik, që prej fillimit të vitit akademik 2023-2024, për studenten Luela Terziu, e cila studion në një program të integruar të ciklit të dytë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, sipas relacionit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

**KRYETAR  
ZAMIRA GJINI**

**ANËTARË**

**MONIKA FIDA**

**VERA OSTRENI ALBANA GJINOPULLI**

**ANIS THODHORJANI**

**ALTINA XHAFERI**

**ENDRIT YZEIRAJ**